



Prishtinë, 23 qershor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1255_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 1055-1 ZK Prelez i Jerlive, me kapacitet të instaluar prej **83.3 kW** në Komunën e Ferizajt, të datës 09.06.2020 me nr. prot. 247/20 të aplikuesit "BALLKAN PETROL" SH.P.K., me adresë: Prelez i Jerlive, Komuna Ferizajt, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 23 qershor 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "BALLKAN PETROL" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ndërtuar sipas Lejes Ndërtimore Nr. 05/351/02-0080529/18 të dt. 05.02.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mjedis, në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 1055-1 ZK Prelez i Jerlive, me kapacitet të instaluar prej **83.3 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Ferizajt.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "BALLKAN PETROL" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE- 9059235 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi "BALLKAN PETROL" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m

